



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 115 Datë 22.08.2012

MBI

**PËR FILLIM PROCEDURE PËR RINOVIMIN E LIÇENSËS” PËR
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE” ME NR. 68, SERIA P08FPP TË MIRATUAR ME
VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 09, DATË
25.01.2008 DHE NR. 58, DATË 03.06.2008**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika “3” dhe nenit 16 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote/te pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, pikave 1.6 dhe 1.8 të Liçensës “Për aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike”, dhe nenit 18, pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.08.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a “Për Rinovimin e Liçensës në Aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike”,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plote/te Pjesshem dhe Rinovimit të Liçensave”,

- **Neni 9, pika 1,**

Formati i aplikimit, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- **Neni 9, pika 2**

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar tërësisht.

- **Neni 9, pika 3**

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, është plotësuar tërësisht.

- **Neni 9, Pika 4**

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit me pakicë të energjise elektrike per klientet tarifore, është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Vendosi :

1. Të fillojë procedurat për rinovimin e liçensës së shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a me Nr. 68, Seria P08FPP, "Për Aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike", të miratuar me Vendimet e Bordit të Komisionerëve Nr. 09, datë 25.01.2008 dhe Nr. 58, datë 03.06.2008.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI